



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:142243
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05876231

KPPP.nr.2045/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “EUROSIG” Sh.A., me adresë në rrugën “2 Korriku” nr.4, në Prishtinë, kundër debitorit “TREPÇA” SH.A , me seli në Mitrovicë, Parku Industrial, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.647/21 të datës 07.06.2021, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Bardh Tasholli me seli të zyrës në Ferizaj, jashtë seancës me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “TREPÇA” Sh.A , me seli në Mitrovicë, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr.647/21 i datës 07.06.2021, i Përbaruesit Privat Bardh Tasholli, për pjesën e detyrimit në shumën prej 53.11 Euro.
- II. REFUZOHET prapësimi i debitorit “TREPÇA” SH.A, dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përbarimor P.nr.647/21 të datës 07.06.2021, të Përbaruesit Privat Bardh Tasholli, sa i përket shumës prej 5,252.18 Euro së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.

III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit Kompania e Sigurimeve “EUROSIG” Sh.A., ndaj debitorit “TREPÇA” SH.A, sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.647/21 të datës 07.06.2021, për shumën prej 53.11 Euro.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr.647/21 të datës 07.06.2021, e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme—faturave dhe atë: Fatura Nr. 025967 - e datës 19.03.2019 në shumë prej 184.08 Euro, Fatura Nr.026098 - e datës 29.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 026083 - e datës 28.03.2019 në shumë prej 212.40 Euro, Fatura Nr.026084 - e datës 28.03.2019 në shumë prej 240.72 Euro, Fatura Nr.026085 - e datës 28.03.2019 në shumë prej 123.90 Euro, Fatura Nr.025476 - e datës 06.02.2019 në shumë prej 108.56 Euro, Fatura Nr.025753 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 198.24 Euro, Fatura Nr.025754 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 240.72 Euro, Fatura Nr.025755 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr.025752 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr.025167 - e datës 11.01.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 025166 - e datës 11.01.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 026052 - e datës 26.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 026785 - e datës 27.05.2019 në shumë prej 719.80 Euro, Fatura Nr.025000 - e datës 21.12.2018 në shumë prej 179.36 Euro, Fatura Nr. 026278 - e datës 12.04.2019 në shumë prej 53.11 Euro, Fatura Nr.027206 - e datës 04.07.2019 në shumë prej 778.80 Euro, Fatura Nr. 027205 - e datës 04.07.2019 në shumë prej 778.80 Euro, me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat e mësipërme t’ia paguaj kreditorit shumën prej 5,305.29 Euro, me kamatëvonesë prej 8 % në vit duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin, për faktin se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri përbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Më tej ka theksuar se e kundërshton faturën nr.026278 e datës 12.04.2019 sepse e njejta nuk është pranuar nga ana e debitorit, gjë e cila vërtetohet sepse e njejta nuk ka vulë të protokollit të pranimit si dhe nuk ka nënshkrim nga ana e pranuesit të faturës. I ka propozuar gjykatës që urdhri të anulohet sa i përket faturës së kontestuar.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka deklaruar se debitori përmes prapësimit ka kontestuar faturën 026278 të datës 12.04.2019, me pretendimin se e njejta nuk ka vulë të pranimit dhe as nënshkrim nga ana e debitorit, mirëpo kreditori vë në dijeni palën dhe gjykatën se për një shërbim të tillë është lëshuar faturë dhe se për të njejtën kreditori ka paguar tatime dhe nuk është paguar. Por për shkak se bëhet fjalë për një shumë simbolike dhe faturë të vogël, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar me të cilën kërkohet që të anulohet vetëm fatura Nr.026278 e datës 12.04.2019, të ndryshohet urdhri përmbarimor sa i përket kësaj fature, dhe të obligohet debitori të paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim sipas tarifës së Odës së Avokatëve.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme faturat dhe atë: Fatura Nr. 025967 - e datës 19.03.2019 në shumë prej 184.08 Euro, Fatura Nr.026098 - e datës 29.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 026083 - e datës 28.03.2019 në shumë prej 212.40 Euro, Fatura Nr.026084 - e datës 28.03.2019 në shumë prej 240.72 Euro, Fatura Nr. 026085 - e datës 28.03.2019 në shumë prej 123.90 Euro, Fatura Nr.025476 - e datës 06.02.2019 në shumë prej 108.56 Euro, Fatura Nr.025753 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 198.24 Euro, Fatura Nr.025754 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 240.72 Euro, Fatura Nr.025755 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr.025752 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr.025167 - e datës 11.01.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 025166 - e datës 11.01.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 026052 - e datës 26.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr.

026785 - e datës 27.05.2019 në shumë prej 719.80 Euro, Fatura Nr.025000 - e datës 21.12.2018 në shumë prej 179.36 Euro, Fatura Nr. 026278 - e datës 12.04.2019 në shumë prej 53.11 Euro, Fatura Nr.027206 - e datës 04.07.2019 në shumë prej 778.80 Euro, Fatura Nr. 027205 - e datës 04.07.2019 në shumë prej 778.80 Euro, në origjinal, dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vendosi sikur në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke anuluar pjesërisht Urdhrin për lejimin e përmbartimit për pjesën sa i përket faturës Nr.026278 - të datës 12.04.2019 në shumë prej 53.11 Euro, duke u bazuar në deklaratimet e kreditorit në përgjigje në prapësim, i cili ka kërkuar nga gjykata që të anulohet detyrimi i debitorit lidhur me këtë faturë, pasi që është shumë simbolike, dhe rrjedhimisht ka kërkuar ndryshimin e urdhrin përmbartimor sa i përket kësaj fature.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor për borxhin që rrjedh nga Fatura Nr. 025967 - e datës 19.03.2019 në shumë prej 184.08 Euro, Fatura Nr.026098 - e datës 29.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 026083 - e datës 28.03.2019 në shumë prej 212.40 Euro, Fatura Nr.026084 - e datës 28.03.2019 në shumë prej 240.72 Euro, Fatura Nr. 026085 - e datës 28.03.2019 në shumë prej 123.90 Euro, Fatura Nr.025476 - e datës 06.02.2019 në shumë prej 108.56 Euro, Fatura Nr.025753 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 198.24 Euro, Fatura Nr.025754 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 240.72 Euro, Fatura Nr.025755 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr.025752 - e datës 01.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr.025167 - e datës 11.01.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 025166 - e datës 11.01.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 026052 - e datës 26.03.2019 në shumë prej 247.80 Euro, Fatura Nr. 026785 - e datës 27.05.2019 në shumë prej 719.80 Euro, Fatura Nr.025000 - e datës 21.12.2018 në shumë prej 179.36 Euro, Fatura Nr.027206 - e datës 04.07.2019 në shumë prej 778.80 Euro, Fatura Nr. 027205 - e datës 04.07.2019 në shumë prej 778.80 Euro, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 5,252.18 Euro, pasi që këto fatura i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, ngase në secilën nga këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, faturat janë dorëzuar në origjinal, dhe këto fatura janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt fakt ky i cili vërtetohet përmes nënshkrimit të debitorit në këto fatura.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i Përmbaruesit Privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 5,252.18 Euro, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës edhe pse kreditori rezultoi pjesërisht fitues i këtij procesi, megjithatë ai nuk e ka bashkangjitur në shkresat e lëndës autorizimin e përfaqësuesit, prandaj gjykata e pati juridikisht të pamundshme t’ia njoh shpenzimet procedurale.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2045/23, me datë 21.06.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.